



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Nazim Gafurri 1 (Miladin Popovic)
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/A/62/2010
DATA E VENDIMIT: 25/02/2010

URDHËR

(1)

N

ë kërkesat me nr 00436, 06059, 06060, 29599 dhe 52437, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) *Në kërkesat me nr 26163 dhe 38964, Komisioni*

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar pronësinë e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(3) *Për kërkesat e përmendura në paragrafët (1) dhe (2) të mësipërm, Komisioni*

urdhëron që

(a) *Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;*

(b) *Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe*

(c) *Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona;*

(4) *Për kërkesat me nr 00269 dhe 06610, Komisioni vendos që kërkesat të refuzohen.*

(5) Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit nga bashkë-pronarët përkatës.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") duke plotësuar dhe ndryshuar Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas nenit 22 të UNMIK/REG/2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e UNMIK/REG/2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposeditim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe

të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të pesëmbëdhjetë prej 22 deri 25 shkurt 2010 në Prishtinë. Gjithsejt 1,083 kërkesa për pronë bujqësore i janë paraqitur Komisionit në seancën e tij të pesëmbëdhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Më tej, dy kërkesa pronësore banesore që i janë paraqitur Komisionit janë ri-kategorizuar gjatës seancës si kërkesa pronësore bujqësore. Komisioni gjithashtu ka finalizuar vendimin mbi shtatëmbëdhjetë kërkesa shtesë të cilat i ishin paraqitur nga Sekretaria Ekzekutive në seancën e tij të 13-të, në të cilat Komisioni kishte ndërprerë shqyrtimet në pritje të konfirmimit të notifikimit fizik të kërkesave për pronat e kërkuara.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat e përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore.

8. Ky vendimi aplikohet për 9 kërkesa, pikërisht për kërkesat me nr. 00269, 00436, 06059, 06060, 06610, 26163, 29599, 38964 dhe 52437. Bazuar në shqyrtimin e tij të kërkesave dhe në dokumentacionin mbështetës gjatë seancës si dhe në informatat e ofruara dhe verifikimin e bërë nga Sekretaria Ekzekutive, i është kthyer një kërkesë Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim dhe shqyrtim të mëtejshëm. Kjo kërkesë, e cila është regjistruar në pjesën B (“Kërkesat e kthyer”) të Listës së bashkëngjitur këtij vendimi, do të shqyrtohet nga Komisioni në kohën e duhur. 1095 kërkesat e tjera për pronën bujqësore, të cilat i janë sjellë Komisionit në këtë seancë, përfshihen në dy vendime tjera, më saktë në vendimin KPCC/D/A/60/2010 dhe KPCC/D/A/61/2010.

9. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi I kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit I parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

10. Të nëntë kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar, ose pala që ka shprehur interes ligjor në prona të tilla ("pala përgjegjëse"), ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të parashikuar me nenin 10.2 të UNMIK/REG/2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 UNMIK/REG/2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

11. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim me përjashtim të kërkesave me nr. 00269 dhe 06610 (si përcaktohet më poshtë në ndarjen 2), paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore ka paraqitur prova që vërtetojnë se ata kanë humbur posedimin për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë gjatë periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

1. Kërkesat e aprovuara

a. Kërkesa nr. 00436

12. Në kërkesën me nr. 00436, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, më pas paraqitësi i kërkesës vdiq në rrjedhën e procedurës. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese që konfirmon pronësinë për pronën e kërkuar; ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Djali i paraqitësit të kërkesës është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive në lidhje me kërkesën dhe ai informon se familja e tij e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar në vitin 2000 në rrethanat e konfliktit 1998-1999 dhe se prona ka qenë e uzurpuar në mënyrë të paligjshme qysh nga ajo kohë.

13. Pala përgjegjëse në këtë rast është uzurpuesi aktual i pronës së kërkuar. Ai nuk ka kërkuar asnjë të drejtë ligjore, megjithatë ai ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes dhe ka dorëzuar një deklaratë ku tregon se ka kultivuar një pjesë të tokës më pëlqimin e bartësit të së drejtës pronësore, por se tani prona është në shfrytëzim të KFOR-it. Ai deklaron se dëshiron ta blejë pronën nga bartësi i së drejtës pronësore i cili i ka thënë atij se nuk dëshiron ta shesë tani pronën, por do t'ia shesë atë palës përgjegjëse nëse vendos dhe kur të vendosë ta shesë atë. Pala përgjegjëse deklaron se atij i ishte dhënë leja për të kultivuar tokën për vitin 2008.

14. Djali i paraqitësit të kërkesës mohon faktin që babai i tij i ka dhënë lejë palës përgjegjëse për të shfrytëzuar pronën e kërkuar edhe ai kërkon riposedimin. Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar riposedimin në formularin fillestar të pranimit të kërkesës.

15. Në situatën kur djali i Paraqitësit të kërkesës ka mohuar që t'i jetë dhënë leja për shfrytëzimin e pronës së kërkuar palës përgjegjëse, dhe në mungesë të dëshmive provuese nga ana e palës përgjegjëse, Komisioni e ka të pamundur të pranojë pohimin e palës përgjegjëse se ai ka pasur lejen e tillë. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka vdekur, Komisioni konsideron se vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk

mund të ndikojnë në vlefshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht duhet të miratohet vendimi në favor të bartësit të së drejtës pronësore.

b. Kërkesat nr. 06059 dhe 06060

16. Në kërkesat nr.06059 dhe 06060, të cilat janë paraqitur nga i njëjti paraqitës i kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka siguruar fletën poseduese e cila tregon se ai zotëron pronat e kërkuara. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar këtë dokument, si të vërtetë.

17. Pronat e kërkuara janë të dyja të uzurpuara nga individ i njëjtë ("Pala përgjegjëse"). Pala Përgjegjëse zyrtarisht nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore apo nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje në lidhje me kërkesën, megjithatë, ai pohon se ka një marrëveshje gojore me paraqitësin e kërkesës për shfrytëzimin e pronës, dhe se ai po negocion me paraqitësin e kërkesës për të blerë pronën. Pala përgjegjëse nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të dokumentuar në mbështetje të pretendimeve të tij.

18. Paraqitësi i kërkesës mohon t'i ketë dhënë leje palës përgjegjëse për të uzurpuar pronën e kërkuar dhe kërkon riposelimin e saj.

19. Në situatën kur paraqitësi i kërkesës ka mohuar që t'i ketë dhënë lejen për shfrytëzimin e pronës së kërkuar palës përgjegjëse, dhe në mungesë të dëshmive provuese nga ana e palës përgjegjëse, Komisioni e ka të pamundur të pranojë pohimin e palës përgjegjëse se ai ka pasur lejen e tillë. Rrjedhimisht kërkesa është e bazuar e duhet të miratohet ashtu si më sipër.

c. Kërkesa nr. 26163

20. Në kërkesën nr paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, përkatësisht vëllait të bartësit të së drejtës pronësore. Bartësi i së drejtës pronësore është i vdekur dhe paraqitësi i kërkesës ka paraqitur certifikatën e tij të vdekjes. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka siguruar listën poseduese në emër të babait dhe vendimin e gjykatës që konfirmon se vëllai i tij përfiton të drejtën pronësore nga babai. Të dy dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive.

21. Pala përgjegjëse në këtë rast është uzurpuesi aktual i pronës. Ai ka kërkuar të drejtë ligjore të pronës dhe ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes, por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi tjetër ose informacion. Ai është shprehur se do të dorëzonte dokumente në mbështetje të mbrojtjes së tij, por nuk ka arritur të sigurojë dokumentet e tilla.

22. Pasi paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar të drejtën pronësore të bartësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar, dhe në mungesë të mbrojtjes të vlefshme nga ana palës përgjegjëse, kërkesa është e bazuar e duhet të miratohet siç është përcaktuar më sipër.

d. Kërkesa nr. 29599

23. Në kërkesën nr. 29599, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djali i bartësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese, vendimin e trashëgimisë dhe kontratën e përkujdesjes jetësore. Të gjitha këto dokumente janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar gjithashtu *ex officio* me autoritetet komunale kadastrale certifikatën e pronës së paluajtshme e cila konfirmon të drejtën pronësore të bartësit të së drejtës pronësore.

24. Pala përgjegjëse në këtë rast është uzurpuesi aktual i pronës së kërkuar. Ai ka kërkuar të drejtë ligjore për pronën, por ka refuzuar të nënshkruajë njoftimin e pjesëmarrjes. Ai pretendon se e ka blerë pronën, por nuk ka dorëzuar asnjë dokument në mbështetje të pretendimit të tij. Në vend të kësaj, ai deklaroi se është detyrë e Sekretarisë Ekzekutive që të kontrollojë dokumentet me institucionet publike përkatëse. Ai deklaroi se ai nuk i kujton numrat e ngastrave pasi i ka blerë ato nga persona të ndryshëm për një periudhë kohe që nga viti 2000.

25. Sekretaria Ekzekutive ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës për ta pyetur nëse ai e kishte shitur ngastrën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës ka informuar se kishte shitur disa parcela të tjera, por jo parcelën për të cilën bëhet fjalë në këtë kërkesë.

26. Pasi pala përgjegjëse ka insistuar se e kishte blerë ngastrën e kërkuar dhe ka treguar se informacioni ishte azhurnuar në regjistrat publik, Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje për të gjendur provat *ex officio*. Sekretaria ka kontrolluar të dhënat e vëna në dispozicion nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për parcelat që rrethojnë parcelën e kërkuar. Rezultoi se në të vërtetë një numër parcelash ishin regjistruar në emër të palës përgjegjëse, por jo parcela e kërkuar. Sekretaria ka vizituar zonën për të përcaktuar nëse ka dëshmitarë të cilët mund të dëshmonin për faktin se pala përgjegjëse e kishte blerë parcelën e kërkuar, por askush nga fqinjët nuk ka treguar gatishmëri për të dhënë deklaratë.

27. Bazuar në provat e dokumentuara, Komisioni e ka të pamundur të mbështesë pretendimet e palës përgjegjëse se ai e ka blerë pronën e kërkuar. Rrjedhimisht, pasi paraqitësi i kërkesës ka siguruar prova të verifikuara që konfirmojnë të drejtën e pronësisë të bartësit të së drejtës pronësore kërkesa është e bazuar dhe duhet të miratohet siç është përcaktuar më sipër.

e. Kërkesa nr. 38964

28. Në kërkesën nr. 38964, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht nipi i bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese e cila konfirmon interesin e së drejtës së pronësisë të bartësit të së drejtës pronësore si dhe certifikatën e vdekjes të bartësit të së drejtës pronësore.

29. Pala përgjegjëse i është drejtuar Sekretarisë Ekzekutive në lidhje me kërkesën edhe ka siguruar kontratën e shitblerjes me anë të secilës synonte të tregonte pronësinë e pronës së pretenduar. Megjithatë, kontrata e shitblerjes, e cila është

verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive ka të bëjë me një parcelë të ndryshme dhe jo me atë të pronës së kërkuar. Kur është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive, pala përgjegjëse ka konfirmuar se kontrata e shitblerjes ka të bëjë me një ngastër tjetër, por ka pohuar se shenja e notifikimit ishte vendosur në pronën e tij. Raporti i notifikimit i përgatitur nga Sekretaria Ekzekutive tregon se në të vërtetë shenja e notifikimit është vendosur në pronën e duhur. Komisioni vëren se është paraqitur kërkesë në AKP në lidhje me një parcelë tjetër të tokës të blerë nga pala përgjegjëse i cili është ftuar të përgjigjet për këtë kërkesën tjetër.

30. Pasi paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar të drejtën pronësore të bartësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar dhe pasi provat e palës përgjegjëse nuk lidhen me pronën e kërkuar, duhet të miratohet vendimi në favor bartësit të së drejtës pronësore për këtë kërkesë, ashtu si përcaktohet më sipër.

f. Kërkesa nr. 52437

31. Në kërkesën 52437, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka siguruar fletën poseduese e cila konfirmon pjesën e saj ideale të pronës. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar gjithashtu vendimin e trashëgimisë në lidhje me pronën e kërkuar, i cili tregon se pjesa e pronës së nënës së paraqitësit të kërkesës është transferuar tek vëllai i paraqitësit të kërkesës. Megjithatë, pasi paraqitësja e kërkesës nuk ka trashëguar asnjë pjesë nga pjesa e pronës së paluajtshme të nënës së saj sipas vendimit të trashëgimisë, informacioni i dhënë nga fleta poseduese e dorëzuar nga paraqitësja e kërkesës në mbështetje të kërkesës së saj mbetet e vlefshme. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar certifikatën e të drejtave pronësore për pronën e paluajtshme në zyrën kadastrale komunale. Certifikata konfirmon të drejtën e pronësisë së paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar.

32. Pala përgjegjëse në këtë rast është uzurpuesi aktual i pronës. Ai ka kërkuar të drejtë ligjore për pronën dhe ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes, por nuk ka dorëzuar prova të mëtejme në lidhje me pronën e kërkuar.

33. Pasi paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar të drejtën e saj të pronësisë për pronën e kërkuar, kërkesa duhet të miratohet në emrin e saj.

34. Në lidhje me sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur bazuar në provat para tij se në kërkesat me nr. 00436, 06059, 06060, 29599, 26163, 38964 dhe 52437:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe

- (c) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

2. *Kërkesat e refuzuara*

a. *Kërkesa nr 00269*

35. Në kërkesën nr. 00269, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë si anëtar i bashkësisë familjare, pikërisht i biri i bartësit të së drejtës pronësore. Bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur ashtu si dëshmohet nga certifikata e vdekjes e dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese e cila tregon se bartësi i së drejtës pronësore është bashkëpronar i pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive ka siguruar ex officio një kopje të certifikatës për të drejtat mbi pronën e paluajtshme nga autoritete komunale kadastrale, e cila konfirmon bashkëpronësinë e bartësit të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar.

36. Prona e kërkuar është uzurpuar nga pala përgjegjëse.

37. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se bartësi i së drejtës pronësore ka humbur posedimin e pronës së kërkuar para vitit 1998, ndoshta në vitin 1995, edhe pse ai nuk është i sigurt. Paraqitësi i kërkesës pohon se pala përgjegjëse ka lëvizur qëllimisht gurët e kufijve për të zmadhuar pjesën e prapme të oborrit dhe se tani paraqitësi i kërkesës nuk e di ku është vija kufitare dhe deri në çfarë largësie ai mund të shfrytëzojë token e tij. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ka shfrytëzuar ngastrën e tij deri në vijën kufitare të vendosur nga pala përgjegjëse. Ndërkohë paraqitësi i kërkesës ka informuar se ai ishte në dijeni të zhvendosjes së vijës kufitare të tokës nga pala përgjegjëse para vitit 1999, ai pretendon se nuk ka pasur kujt t'i ankohet për të zbatuar të drejtën e tij ligjore për shkak të diskriminimit kundër nacionalitetit shqiptar ndërmjet viteve 1989-1999 për të pasur qasje në institucionet publike.

38. Komisioni vëren se, edhe pse kanë ekzistuar praktika të tilla diskriminuese gjate këtyre viteve, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të sigurojë informacion për hapat që ka ndërmarrë për të zbatuar të drejtën e tij ligjore pas vitit 1999 kur këto praktika pushuan, duke përfshirë përdorimin e topografit për të bërë vlerësimin e kufijve tokësore.

39. Sidoqoftë, shihet qartë nga provat se paraqitësi i kërkesës nuk ka humbur posedimin e pronës së kërkuar në rrethanat që lidhen drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur të vitit 1989-1999 ashtu si kërkohet nga neni 3.1 i UNMIK/REG/2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Kërkesa e paraqitësit të kërkesës përbënë një kontest privat midis paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse që ka lindur para konfliktit e për rrjedhojë bie jashtë juridiksionit të Komisionit. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për ta çuar kërkesën e tij në gjykatën vendore kompetente për t'u zgjidhur

b. *Kërkesa nr. 06610*

40. Në kërkesën nr. 06610, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij paraqitësi i kërkesës

ka siguruar fletën poseduese të vitit 2001, e cila tregon se ai është bashkëpronar i pronës. fleta poseduese është verifikuar në zyrën komunale kadastrale.

41. Pala përgjegjëse deklaron se babai i tij e ka blerë pronën në vitin 1978 nga xhaxhai/daja i tij. Sipas palës përgjegjëse, babai i tij e ka paguar çmimin e plotë të blerjes dhe e ka tokën në posedim që nga viti 1978 derisa vdiq në vitin 2007. Më tej, ai deklaron se xhaxhai/daja e ka blerë pronën në vitin 1973 nga babai i paraqitësit të kërkesës, megjithatë prona ka mbetur e regjistruar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës. Pala përgjegjëse deklaron se babai i paraqitësit të kërkesës ka qenë në dijeni për shitjen e pronës tek babai i palës përgjegjëse në vitin 1978, pasi babai i paraqitësit të kërkesës ka banuar në komunën e Podujevës deri në vitin 1999. Pala përgjegjëse ka shpjeguar se ai nuk e ka kontratën e shitblerjes midis babait të paraqitësit të kërkesës edhe xhaxhait/dajës së tij dhe nuk ka mundur ta gjejë atë pasi disa nga dokumentet familjare ishin djegur gjatë luftës.

42. Në përgjigje, paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se prona e kërkuar ishte shitur në vitin 1966 dhe nuk ishte shfrytëzuar nga familja e paraqitësit të kërkesës që nga ajo kohë. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës pohon se blerësi nuk e ka paguar çmimin e plotë të blerjes dhe se babai i paraqitësit të kërkesës ka vazhduar të paguajë taksën. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se ka ekzistuar një kontratë shitblerje, edhe pse ai nuk ka kopje të saj, por kontrata asnjëherë nuk është vërtetuar në gjykatë.

43. Komisioni konsideron se duke u bazuar në atë që u tha më sipër, kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk ka të bëjë me rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur të vitit 1989-1999. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për ta çuar kontestin e tij më palën përgjegjëse në gjykatën vendore kompetente.

B. Vërejtje përmbledhëse

44. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

45. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 e miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.

46. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesës ose bartësve të së drejtës pronësore, sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoritetet kadastrale ose gjykatat vendore, në përputhje me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo shkelje serioze të së drejtës materiale apo procedurale; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA52437	KPA06059	KPA29599	KPA00269	KPA06060	KPA06610	KPA26163
KPA38964	KPA00436					